VENDIM
Nr.1472, datë 12.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR MINISTRINË E DREJTËSISË DHE INSTITUCIONET, NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit, për vitin 2008, për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore, nga data 31 tetor më 25 dhjetor 2008, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

LISTA E OBJEKTEVE DHE AFATET MAKSIMALE PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PROKURIMIT

Nr.	**Objekti**	**Vlera lekë**	**Afati për lidhjen e kontratës**
1	Blerje karburanti	5 010 100	24.12.2008
2	Sistem kamerizimi, burgjet Korçë dhe Fushë-Krujë	20 000 000	24.12.2008
3	Ushqime koloniale	6 000 000	24.12.2008
4	Pikë lidhje e dytë burgu, Zaharia Krujë	3 350 000	24.12.2008
5	Pus uji burgu Lushnjë	1 800 000	24.12.2008
6	Riparime tualetesh + dyer në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve	700 000	24.12.2008
7	Motogjeneratorë dhe kaldaja për sistemin e burgjeve	7 200 000	24.12.2008
8	Sistem rrufepritës për IEVP Peqin dhe antenën e TV për IEVP Peqin dhe Korçë	5 000 000	24.12.2008
9	Ushqime të freskëta për IEVP Tepelenë	1 452 600	24.12.2008
10	Shtypja e Fletores Zyrtare dhe botime të tjera	18 700 000	24.12.2008